REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr1328 Prot

Maliq, më 02.03.2026

VENDIM

Nr 35, datë 27.02.2026

PËR
"MBLEDHJEN E TAKSAVE VENDORE NËPËRMJET AGJENTIT TATIMOR"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" I ndryshuar, neni 8 neni 9 pika 1, nënpika 1.1 gërma "b", neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak''*gërma "dh", neni 55 "*Votimi"*pika 3, neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*"pika "c",, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", të ndryshuar, Kreu VII, neni 35 " *Tarifat vendore dhe administrimi i tyre*" pika 2 në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligji nr 9902/2008 " *Për mbrojtjen e konsumatorëve*" i ndryshuar dhe nevojës për rritjen e eficensës së mbledhjes së të të ardhurave, Këshillit Bashkiak Maliq,

VENDOSI:

I. Të miratojë mbledhjen e Taksave dhe Tarifave vendore nëpërmjet Agjentit Tatimor për taksapaguesit familjarë.

II. Taksat dhe Tarifat vendore që do të mblidhen nëpërmjet agjentit tatimor janë:

- Taksë ndërtesë
- Taksë trualli
- Taksë toke
- Tarifat: pastrim, ndriçim, gjelbërim, për mirëmbajen e varrezave dhe tarifë për mirëmbajtje kanale kulluese

III. Agjenti tatimor ngarkohet që të përfshijë taksat/tarifat vendore në faturën e vet, të arkëtojë pagesat për llogari të Bashkisë Maliq si dhe të transferojë të ardhurat e mbledhura brenda afateve të përcaktuara.

IV. Bashkia Maliq ngarkohet të lidhë Kontratë me agjentin tatimor ku të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e paleve, procedurat e mbledhjes dhe të transferimit të fondeve si dhe kompensimin e shërbimit të kryer.

III. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e të Ardhurave , Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria Juridike.

IV. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore",* indryshuar

Miratuar me 20 vota
Vota Pro 20
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.03.2026

NË MUNGESË

DHE ME POROSI

ZV/KRYETARI I KËSHILLIT

Enida AVDOLLI



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 bm@.bashkiamaliq.gov.al